

- Procedura e regjistrimit të kërkesës në Rregjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve:
 1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.
 2. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.
 3. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, i jepen kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.
 4. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.
 5. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
 - a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
 - b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
 - c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
 - ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
 - d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
 6. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për bashkinë.